



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TE LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN021220240007

Tiranë, më: 17.01.2025

Komisioni 6

VENDIM
PËR VNM PARAPRAKE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që **ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar** për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT OST "SH.A

Nr. NIPT-i: K42101801N

Adresa e selisë: Yrshek, autostrada Tirane-Durres, km 9, Kashar

Personi përgjegjës: Skerdi Drenova

Për të zhvilluar projektin: “**Ndërtimi i linjes së re L.110-36 Fushe – Kuqe – Gjiri Lalzit (Rikonstruksion I pjesshem i nenstacionit Fushe – Kuqe)**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë pika b) Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë, transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartesi (projekte që nuk përfshihen në shtojcen I)

Vendndodhja: Qarku Durres, Fushe-Kuqe, Kurbin, Lezhë.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe :110km²

Gjatësi: 200 km

(Bashkangjitur Aneksi I, me planvendosjen e objektit si dhe koordinatat)

Bazuar në nenin 11 të Ligjin Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, më poshtë po listojmë.

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

- Aktiviteti nuk cënon jetën e banorëve përreth.

- Mendimin e ARM-së.
- Mendimin e AMBU-së,
- Mendimin e MIE-es
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 6, datë 16.01.2025, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.613, datë 17.12.2024, nr.13238 prot, për “Krijimin e komisionit për vlerësimin e aplikimeve dhe kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake e të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

• **Mendimin e institucioneve të konsultuara:**

Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet si më poshtë vijon: Zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve si më poshtë:

- Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

• Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon □ Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, gjatë fazës së punimeve, rekomandohet:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i punimeve dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”

• Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve për këtë aktivitet shprehen se:

Sa shprehet në raporte vlerësojnë se:

- nuk parashtrohen dhe saktësohen të dhënat/informacionet për përdorimin e sipërfaqes që do të përdoret përherë apo përkohësisht nga projekti (kjo bazuar në VKM nr.686, datë 29.7.2015, të ndryshuar dhe VKM 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit në mjedis);
- kërkojmë që sipërfaqet e marra në përdorim, ku do zhvillohet projekti të jenë me emërtimet (ngastër/nëngastër) sipas kodit unik të regjistrit kadastral pyjor e kullosor;
- për sipërfaqet me formë përdorimi pyll apo kullotë, shprehemi që duhen zbatuar parashikimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, veçanarisht pikën 6, neni 10 dhe nenin 12, të tij, si dhe ligjit 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”,
- të përcaktohet sa është sipërfaqja (masën e sipërfaqes) që do të hiqet nga fondi pyjor/kullosor dhe të ndiqen procedurat sipas VKM nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësim në volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, lidhur me projektin: “Ndërtimi i linjës së re L.110-36 Fushë Kuqe - Gjiri i Lalzit (Rikonstruksioni i Pjesshëm i Nënstacionit Fushë Kuqe)”, Qarku Durrës dhe Lezhë me zhvillues “OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT OST” dhe aplikues “TAULANT” shpk, me nr. Aplikimi AN021220240007, rezulton se pika me koordinata nr. 10 dhe një pjesë e linjës, ndodhen në zonën e mbrojtur RNM “Kune – Vain – Patok – Fushë Kuqe - Ishëm”, shpallur me VKM nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të Sipërfaqeve ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, nënzona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q).

Referojuni ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 19, pika 1 dhe 3, Neni 49 si dhe VKM-së nr. 60, Aneksi nr. 16.

*Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet se:*Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për VNM paraprahe të subjektit “Taulant” Sh.p.k, me zhvillues projekti subjektin “OST”, në lidhje me projektin: “Ndërtimi i linjës së re ajrore 110 kV Gjiri i Lalzit – Fushë Kuqe (Rikonstruksioni i pjesshëm i nënstacionit Fushë Kuqe)”, me vendndodhje, Qarku Durrës, me të dhënat: Nr. AN021220240007, të datës 02.12.2024, ju sqarojmë se:

Siç jemi shprehur edhe nëpërmjet shkresës datë 10.12.2024, referuar koordinatave të shtrirjes së linjës ajrore të dhëna në Raportin Teknik të paraqitur nga ju, si edhe të dhënave për trupat ujorë sipas shtresës Hidrografia në Gjeoportalin e ASIG, rezulton se projekti nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore.

*Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë shprehet se:*Në vijim të aplikimit me Nr. AN021220240007 të depozituar në sistemin elektronik të lejeve, për të cilin keni kërkuar pëlqimin/dakortësinë për VNM-në Paraprahe për objektin: “Ndërtimi i Linjës së Re L.110-36 Fushë Kuqe-Gjiri i Lalzit (Rikonstruksioni i Pjesshëm i Nënstacionit Fushë Kuqe)”, me subjekt zhvillues OST sh.a., pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko ligjor të vënë në dispozicion ju bëjmë me dije se: Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe në mbështetje të politikave qeveritare për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike në vend vlerëson fuqizimin e rrjeteve të sistemit elektorenergjetik duke marrë parasysh sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike.

Referuar ligjit Nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, OSSH sh.a. për zhvillimin e rrjetit duhet të marrë në konsideratë planifikimin urban dhe rajonal të zonës ku shtrihen instalimet e transmetimit, legjislacionin e mbrojtës së mjedisit dhe të marrë masat efikase për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit si dhe të garantojë kostot për ndërtimin e linjës dhe çdo kosto tjetër që rrjedh nga ky ndërtim.

Gjithashtu OSSH sh.a. miraton pranë Entit Rregullator të Energjise planin 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes me fokus kryesisht zhvillimin dhe përmirësimin, sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, eficientë të energjisë dhe menaxhimin e kërkesës duke synuar rritjen e kapacitetit transmetues të tyre dhe në vijim miraton çdo vit nëpërmjet organeve drejtuese të saj planin vjetor të investimeve.

Për sa më sipër, MIE në mbështetje të politikave qeveritare për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike në vend shprehet parimisht dakort për zhvillimin e tij si ku ndërkohë që paraqitja e dokumentacionit të plotë tekniko ligjor sipas legjislacionit në fuqi është përgjegjësi e zhvilluesit të projektit, në rastin në fjalë OSSH sh.a.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal në të. Sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Të merren masat e nevojshme për menaxhimin e ujërave të kanaleve ujëtare dhe të kullimit të tokave bujqësore, dhe mos shkarkimin e dherave apo ndotësve të tjerë në to.
- Mbetjet inerte, të gjeneruara gjatë procesit të ndërtimit (dhera), të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, në bashkëpunim me autoritetet vendore.
- Gjatë transportit të materialeve ndërtimore, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- Të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që përdorin lubrifikantë të çdo lloji t'i nënshtrohen kontrolleve periodikë mbi gjendjen e tyre teknike. Të gjitha pjesët që rezultojnë të dëmtuara dhe burime rrjedhjesh të riparohen menjëherë. Në raste të rrjedhjeve aksidentale, të bëhet pastrimi i menjëhershëm i vendit duke e larguar pjesën e ndotur të tokës (dherave), për të mos lejuar depërtimin e ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe nivelin e ujit nëntokësor të zonës.
- Të monitorohet cilësia e ajrit bazuar në dispozitat e rregulloreve përkatëse, përfshirë VKM 352/2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedisin dhe standartet mbi disa ndotës".
- Të respektohen standardet zyrtare për zhurmat dhe dridhjet, siç parashikohet në Ligjin 9774/2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis".

Në përfundim të ndërtimit të punimeve të kryhet rehabilitimi i zonës, sistemit të sheshit, mbjellja e pemëve. Të rimbillen druret që do të shkulet ose druret që do të demtohen të zëvendësohen me fidane të rin.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës për aktivitetin shprehët parimisht dakord. Në keto kushte sjellim në vëmendje që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal. Gjithashtu, sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Mbetjet inerte, të gjeneruara gjatë procesit të zbatimit të projektit (dhera), të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, në bashkëpunim me autoritetet vendore.
- Mbetjet e tjera, të gjeneruara gjatë fazës së punimeve, të cilat duhet të asgjësohen/trajtohen dhe të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar i pajisur me Lejet/Licensat përkatëse.

- Të mbulohen mjetet e transportit që transportojnë dherat dhe materialet e tjerë të ndërtimit dhe të pastrohen para daljes jashtë kantierit.
- Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
- Ujerat e gjeneruara gjatë fazes së ndërtimit të trajtohen sipas Ligjit Nr.111/2012 Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Të bëhet lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës.
- Të mos shkarkohet asnjë lloj derdhje të mbetjeve inerte jashtë territorit të sheshit të projektit.
- Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetëm brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.

3. Masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis:

3.1. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.

- 3.2. Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 3.3. Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
- 3.4. Subjekti ka detyrimin e menaxhimit të mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara të pajisura me Kod Unik
- 3.5. Subjekti të kontaktojë me pushtetin vendor për largimin e mbetjeve inerte, që do të gjenerohen gjatë fazës së shëmbjes së objekteve ekzistuese.
- 3.6. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar, brenda gjurmes dhe koordinatave të deklaruara.
- 3.7. Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 3.8. Në rast se subjekti do të shfrytëzojë burimet ujore atëherë duhet të pajiset me leje shfrytëzimi nga KBU përkatëse.
- 3.9. Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 3.10. Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.11. Të merren masa për sigurimin e ajrosjes dhe ventilimit të ambienteve të brendshme.
- 3.12. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 3.13. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara.
- 3.14. Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).

- 3.15. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 3.16. Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 3.17. Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 3.18. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- 3.19. Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.20. Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.21. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.22. Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.
- 3.23. Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 3.24. Në rast se do të jetë e nevojshme përdorimi i gjeneratorit, sugjerojmë që gjeneratori të jetë tip silencioz me lëndë djegëse naftë të pastër, me parametrat e shitjes në treg.
- 3.25. Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e rajonit përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.26. Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.27. Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur peisazhin dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 3.28. Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 3.29. Rekomandojmë respektimin e rregullave për sigurinë, higjenën dhe shëndetin në punë.
- 3.30. Sugjerojmë që, gjatë fazës së zhvillimit të punimeve të mënjanohet dëmtimi i individëve bimorë që nuk e pengojnë shfrytëzimin dhe nëse konstatohet bimësi me vlerë (ekonomike, mjekësore, me status mbrojtjeje, etj), ajo të ruhet dhe të lajmërohen autoritetet përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse për ruajtjen.
- 3.31. Në rast të konstatimit të specieve bimorë që mund të ripërdoren për qëllime rehabilitimi, ato të zhvendosen me kujdes e të ruhen në kushte të përshtatshme.
- 3.32. Në çdo rast të dëmtimit të drurëve të bëhet kompesimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi. Përpara se bimët të mbillen të studiohet morfologjia dhe kushte të tjera të zonës në mënyrë që të sigurohet një restaurim dhe mbjellje e efektshme.
- 3.33. Subjekti duhet të shfrytëzojë rrugët hyrëse ekzistuese duke shmangur hapjen e rrugëve të reja;
- 3.34. Subjekti duhet të vendosi shenja paralajmëruese rrugore dhe përgatitjen e udhëzime për drejtuesit e automjeteve, me qëllim uljen e numrit të aksidenteve;
- 3.35. Subjekti nuk duhet të kryej punime gjatë orareve të qetësisë publike, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin.

- 3.36. Para funksionimit të aktivitetit, subjekti duhet të marrë masa lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose kanalizimin e tyre me rrjetin kryesorë të zonës.
- 3.37. Sipërfaqet e gjelbëruara duhet të mirëmbahen (punime krasitje, ujitje, pastrimi, etj), të shtohen dhe të monitorohen në vazhdimësi nga subjekti, me qëllim garantimin e suksesit të rehabilitimit.
- 3.38. Të respektohet Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, Neni 19, pika 3 Neni 49
- 3.39. Të respektohet ligji nr.57/2020 “Për pyjet” dhe ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar,
- 3.40. Të realizohet rehabilitimi i sipërfaqeve pas përfundimit të projektit.
- 3.41. Të respektohet ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar,
- 3.42. Të respektohet ligji nr.10006 datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar,
- 3.43. Të respektohet ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar
- 3.44. Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit.”

4. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	18.07.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	18.07.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	18.07.2025	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	18.07.2025	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	18.07.2025	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	18.07.2025	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
 - Informacion në momentin e fillimit të punimeve
 - Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
 - Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
 - Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
 - Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
 - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 30.000 leke.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit dhe koordinatat





Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit Gauss- Kruger Zone 4

Nr.	E	N
1	4379589.40	4596378.63
2	4379556.33	4596425.22
3	4379727.40	4596808.33
4	4379580.17	4598486.23
5	4379867.77	4599628.86
6	4380695.11	4600333.45
7	4380734.88	4602558.78
8	4381225.84	4603841.40
9	4381240.17	4603869.24
10	4384639.98	4608447.82
11	4385276.17	4610176.84
12	4385930.94	4611093.45
13	4386334.99	4612125.00
14	4386345.06	4612993.07
15	4386823.15	4613570.77



Planimetria e përgjithshme e linjës së tensionit Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe